



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 69

6 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8119 datë 22.4.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 3035
Vendim i KM nr. 307, datë 10.4.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fushë-Kuqe të qarkut të Lezhës..... 3035
Vendim i KM nr. 323, datë 18.4.2013	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, për bashkëpunim në fushën e veterinarisë. 3036
Vendim i KM nr. 326, datë 18.4.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kthellë të qarkut të Lezhës..... 3040
Vendim i KM nr. 327, datë 18.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 3041
Vendim i KM nr. 329, datë 18.4.2013	Për miratimin e tarifës së biletës së Cirkut Kombëtar..... 3042
Vendim i KM nr. 331, datë 18.4.2013	Për autorizimin e shoqërisë “ANSA” sh.p.k., për importin e mbetjeve të polietilenit, për qëllime riciklimi..... 3042

Vendim i KM nr. 333, datë 25.4.2013	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese trualli të pronës “Qendra e formimit policor” Sauk, Tiranë, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.....	3043
Vendim i KM nr. 334, datë 25.4.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për përballimin e shpenzimeve të transportit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me humbjen e jetës së zonjës Linda Ihsani.....	3046
Vendim i KM nr. 336, datë 24.4.2013	Për emërimin në detyrë të prefektit të qarkut të Durrësit.....	3046
Vendim i KM nr. 337, datë 26.4.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 515, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillit të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”.....	3047
Vendim i KM nr. 338, datë 26.4.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)”, të ndryshuar.....	3047
Vendim i KM nr. 341, datë 24.4.2013	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	3048
Vendim i KM nr. 342, datë 24.4.2013	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	3048
Vendim i KM nr. 343, datë 24.4.2013	Për emërim në detyrë.....	3048
Vendim i KM nr. 344, datë 24.4.2013	Për disa shtesa në vendimin nr. 180, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”.....	3049
Vendim i KM nr. 346, datë 24.4.2013	Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta dhe objekteve të vjetra të ish-uzinës “Dinamo” e re, Tiranë.....	3049
Udhëzim i MD&MF nr. 383/8, datë 29.4.2013	Për përcaktimin e tarifave për shërbimet e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.....	3057

DEKRET
Nr. 8119, datë 22.4.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--|---|
| 1. George William Robert Erwin Sturm | 12. Jean-Luc Andre Daniel Daniel Lucien Louis Emery |
| 2. Nancy Jane Carl Edward Sturm (Rader) | 13. Arsim Fehmi Zogaj |
| 3. Joel William George William Sturm | 14. Nazmi Elez Hasanaj |
| 4. Kujtim Bekë Maloku | 15. Saniye Bislim Salihaj (Bitiq) |
| 5. Arsim Ramadan Gashi | 16. Xhevat Xhezair Osmani |
| 6. Faruk Ajvaz Bojaxhi | 17. Viktor Gjon Berisha |
| 7. Irina Aleksandr Alla (Pismjenskaja) | 18. Shukri Isuf Salihi |
| 8. Faruk Zeqir Vladi | 19. Michele Marino Lamanuzzi |
| 9. Valmira Reshit Boksi (Bulaj) | 20. Haki Halil Morina |
| 10. Erkin Hasan Çelik | 21. Valdete Sabit Noni (Zuzaku) |
| 11. AidaRrahmanLlalloshi-Sherifi (Llalloshi) | 22. Lirim Imer Kukaj |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 307, datë 10.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
FUSHË-KUQE TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fushë-Kuqe të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Fushë-Kuqe të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr. 1178, datë 20.8.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Fushë-Kuqe të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fushë-Kuqe, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fushë-Kuqe

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-5	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
6-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16-17	Varrezat publike	Në pronësi
53-64	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
69,72,75,77,80,83,86,87, 90,93,106-114,116,117, 119-121	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
94-104	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
115,118	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Nuk transferohet sipërfaqja 248.5 ha trajtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 18.6.2008	Në përdorim

VENDIM

Nr. 323, datë 18.4.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E VETERINARISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës, për bashkëpunim në fushën e veterinarisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJË-HERCEGOVINËS, PËR BASHKËPUNIM NË
FUSHËN E VETERINARISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave i Bosnjë-Hercegovinës, (më poshtë të quajtura “Palët”),

me dëshirën për të lehtësuar qarkullimin e kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore, duke ndarë në të njëjtën kohë angazhimin për të mbrojtur kafshët dhe shëndetin publik, me qëllim për të parandaluar futjen e sëmundjeve infektive të kafshëve dhe produkteve shtazore të pasigurta që lidhen me to;

duke dëshiruar të çojnë më tej zhvillimin e bashkëpunimit teknik dypalësh dhe rajonal në sektorin veterinar;

pa cenuar detyrimet e tyre që lindin nga marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, Palët ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Importi dhe transiti i kafshëve të gjalla dhe produkteve me origjinë shtazore (më poshtë “dërgesa”) lejohen nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Plotësohen dhe respektohen kushtet përkatëse të shëndetit veterinar, aktuale dhe detyruese të vendit importues apo të vendit transit;

b) lëshohen lejet nga autoriteti kompetent i vendit importues apo i vendit transit;

c) “dërgesa” shoqërohet me certifikatën e shëndetit veterinar, e hartuar të paktën në shqip dhe në një nga gjuhët zyrtare të përdorura në Bosnjë dhe Hercegovinë, në përputhje me plotësimin e të gjitha kërkesave të përshkruara nga vendi importues apo vendi transit.

2. Për qëllimet e zbatimit të paragrafit 1 të këtij neni, Palët angazhohen:

a) të informojnë me mjete të rregullta dhe menjëherë njëra-tjetrën mbi kushtet veterinarë aktuale e detyruese që importin e “dërgesave” drejt apo transit, territorit të vendeve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

b) të shkëmbejnë modelet e certifikatave shëndetësore veterinarë që zbatohen në importin e “dërgesave” drejt apo transit, territorit të vendeve nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.

Në të njëjtën kohë ato bien dakord të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo ndryshim të këtyre formularëve.

Neni 2

1. Nëse në pikën e hyrjes, apo në vendin e destinacionit, provohet se “dërgesa” nuk përmbush kushtet e deklaruara në certifikatën shëndetësore veterinarë, autoriteti kompetent i palës importuese do të aplikojë masa në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj kombëtare.



2. Kur shfaqet situata e përshkruar në paragrafin 1, autoriteti kompetent i palës përkatëse do të informojë në kohën e duhur autoritetin kompetent të palës eksportuese lidhur me çrregullimet e identifikuar dhe masat e vendosura dhe do t'i raportojë për ato palës tjetër brenda 24 orëve.

Neni 3

1. Autoritetet kompetente të palëve marrin përsipër:

a) shkëmbimin e informacionit për kushtet që lidhen me sëmundjet infektive, të raportuara në vendet e tyre përkatëse, duke deklaruar emrat e vendeve, kodin dhe emrin e rajoneve të epizootologjisë, si dhe numrin dhe llojet e kafshëve të rrezikuara, në bazë mujore. Raportet mujore mund të shkëmbehen në mënyrë elektronike, me e-mail apo internet;

b) shkëmbimin e menjëhershëm e të ndërsjellë të informacionit me shkrim nëse shfaqet ndonjë sëmundje me njoftim të menjëhershëm të OIE-së dhe informimin e rregullt të secilës palë mbi zhvillimin e mëtejshëm të sëmundjes;

c) shkëmbimin e informacionit për parandalimin dhe masat e kontrollit të ndërmarra me qëllim mbrojtjen e blegtorisë së tyre nga sëmundjet infektive.

2. Gjithashtu, autoritetet kompetente marrin përsipër:

a) promovimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe projektet për luftimin dhe kontrollin e sëmundjeve me njoftim të menjëhershëm të OIE-së, brenda FAO-së dhe OIE-së në grupin trepalësh OIE/EC/FAO;

b) aktivitete të ndërsjella për përmirësimin e mbikëqyrjes, parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të kafshëve.

Neni 4

1. Autoritetet kompetente të palëve nxisin bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh në fushën veterinare, veçanërisht përmes:

a) shkëmbimit të rregulloreve, botimeve profesionale apo shkencore që i përkasin fushës veterinare;

b) shkëmbimit të planeve të tyre aktuale të monitorimit të mbetjeve dhe kontrollit të mbetjeve bio të kafshët dhe produktet me origjinë shtazore, si dhe rezultatet vjetore të marra nga zbatimi i këtyre planeve;

c) lehtësimit të bashkëpunimit midis institucioneve shkencore, laboratorëve diagnostikues e analitikë të përfshirë në studimin dhe kërkimin e sëmundjeve të kafshëve dhe aspektet publike me interes të përbashkët: mbrojtjen e shëndetit publik;

d) shkëmbimit të ndërsjellë të asistencës teknike dhe ekspertizës në fushën e mbikëqyrjes, parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve të veçanta të kafshëve;

e) në rast emergjence dhe me kërkesë të njëjës nga palët, shkëmbimit të shtameve të patogjeneve për qëllime eksperimentale apo diagnostike, si dhe ekspertizës së përbashkët për zbatimin e teknikave diagnostikuese;

f) shkëmbimeve të ekspertëve veterinarë me synim që të kuptojnë organizimin dhe funksionimin e shërbimit veterinar, procedurat e eksportit dhe të certifikimit, zbulimin e sëmundjeve dhe procedurat e raportimit, duke përfshirë gjendjen e përgjithshme të shëndetit të kafshës dhe sistemet e informacionit;

g) nxitjen e përpjekjeve për të organizuar dhe mbajtur takime vjetore të ekspertëve për çështje të pazgjidhura dhe me interes të përbashkët në rastet e një emergjence dhe me kërkesën me shkrim nga njëra nga palët, për organizimin e takimeve speciale të zyrtarëve më të lartë veterinarë, me synim për të koordinuar masat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive të kafshëve.

2. Shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i aktiviteteve referuar paragrafit 1 dhe në veçanti pikat “f” dhe “g” të saj, do të mbulohen në përputhje me rregullat e përgjithshme si më poshtë:

a) Kur vizitat e ekspertëve referuar paragrafit 1 (f) bëhen në vijim të një ftese zyrtare të palës pritëse, kostot organizative, si dhe shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit të ekspertëve vizitorë do të mbulohen nga pala pritëse.

Kur vizitat e ekspertëve referuar paragrafit 1 (f) bëhen në vijim të një kërkesë formale të palës vizitore, kostot organizative do të mbulohen nga pala pritëse, ndërsa kostot e udhëtimit dhe të akomodimit të ekspertëve vizitorë do të mbulohen nga pala vizitore.

b) Takimet referuar në paragrafin 1 (g) do të organizohen mbi një bazë të ndërsjellë dhe kostot organizative do të mbulohen nga pala pritëse, ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera për jetesë të ekspertëve udhëtues do të mbulohen nga pala e vendit që ata i përkasin.

Neni 5

Nëse zbulohet ndonjë nga sëmundjet me njoftim të menjëhershëm të OIE-së në territorin e njëres nga palët, autoriteti kompetent i palës tjetër ka të drejtën të kufizojë apo të ndalojë importin apo transitin e kafshëve, të cilat u përkasin specieve të ndjeshme ndaj kësaj sëmundje, që vijnë nga zona ku është shfaqur infeksioni. Kufizimi dhe ndalimi i importit dhe transitit mund të shtrihen në të njëjtat kushte për ndonjë dërgesë tjetër, nëpërmjet së cilës mund të transmetohet sëmundja.

Neni 6

Për qëllimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, autoritetet kombëtare kompetente të palëve do të jenë:

- a) për Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Shërbimit Veterinar e Republikës së Shqipërisë;
- b) për Bosnjë-Hercegovinën: Zyra veterinare e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që lind nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje zgjidhet në nivelin e përfaqësuesve të autoriteteve kompetente kombëtare të palëve.

Në qoftë se nuk merret rezultat i kënaqshëm, çështjet e mosmarrëveshjeve zgjidhen nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Neni 8

1. Dispozitat dhe qëllimi i zbatimit të kësaj marrëveshjeje mund të shtohen apo ndryshohen nëpërmjet një miratimi zyrtar, me shkrim, të nënshkruar nga të dyja palët.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e njoftimit të fundit të shkëmbyer përmes rrugëve diplomatike në lidhje me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Kjo marrëveshje zbatohet për një periudhë 5-vjeçare dhe mund të denoncohet apo pezullohet përpara përfundimit të saj nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër përmes rrugëve diplomatike. Denoncimi hyn në fuqi 60 ditë dhe pezullimi 30 ditë nga data e njoftimit. Zgjatja e marrëveshjes bëhet me kërkesë me shkrim të njëres prej palëve 6 muaj para përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes dhe pas konfirmimit me shkrim të palës tjetër.

Bërë në Tiranë, më 2.4.2013 në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, gjuhët zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës (kroate, boshnjake dhe serbe) dhe angleze ku secila nga tekstet konsiderohet njëlloj i barasvlershëm. Në rast mosmarrëveshjeje teksti në anglisht ka përparësi.



VENDIM
Nr. 326, datë 18.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KTHELLË TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kthellë të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kthellë të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr. 1640, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kthellë të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Kthellë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kthellë

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
343-346	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
347	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
348-356	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
357, 358	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
359-361	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
362-376	Varrezat publike	Në pronësi
387-433	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
434-436, 439-441, 444-446, 449, 450, 455-458, 462-463, 467-469, 473-474, 477-480, 483	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Nuk transferohen sipërfaqet e trajtuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 18.6.2008	Në përdorim
437, 438, 442, 443, 447, 448, 451-454, 459-461, 464-466, 470-472, 475, 476, 481, 482	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
496-505	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 327, datë 18.4.2013

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, e 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës "A" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", shtohen individët e renditur në shkronjën "a" të listës "Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Në fund të shkronjës "C" "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", shtohen individët e renditur në shkronjën "b" të listës "Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

3. Nga lista e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "c" të listës "Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida, me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berish

a) Lista e shtuar e individëve në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me Talibanët.":

1. AHMED SHAH; NOORZAI; OBAIDULLAH;

b) Lista e shtuar e individëve në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida.":

1. DJAMEL: AKKACHA;
2. ABDERRAHMANE: OULD EL AMAR;
3. HAMADA: OULD MOHAMED ELKHAIRY ;
4. IYAD: AG GHALI;

c) Lista e individëve të çregjistruar nga "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida.":

1. SULIMAN: HAMD: SULEIMAN: AL-BUTHE;
2. USAMA: MUHAMMED: AWAD: BIN LADEN;
3. MAMOUN 2: DARKAZANLI;
4. ABDELGHANI 2: MZOU DI;



VENDIM
Nr. 329, datë 18.4.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË BILETËS SË CIRKUT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifës së biletës së Cirkut Kombëtar, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS 1
TARIFAT PËR BILETAT E CIRKUT KOMBËTAR

Nr.	Emërtimi	Tarifa
1	Bileta për të rritur	100 lekë
2	Bileta për fëmijë	50 lekë

VENDIM
Nr. 331, datë 18.4.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “ANSA” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË POLIETILENIT, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “ANSA” sh.p.k., për importin e mbetjeve të polietilenit, me kodet GH 01lex 391510 dhe B1-B3010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve të polietilenit, që do të importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 3 600 (tri mijë e gjashtëqind) tonë në vit.

3. Mbetjet do të importohen nga shteti i Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi dhe vendet e Bashkimit European. Transporti të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të plotësohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë, sipas kërkesave të anekseve III dhe IV, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, shoqëria “ANSA” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III dhe IV, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me një raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

5. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të polietilenit nga shoqëria “ANSA” sh.p.k., është 1-vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të polietilenit nga shoqëria “ANSA” sh.p.k., edhe pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe me ato në të cilat do të bëhet kalimi transit për autorizimet përkatëse, në bazë të të cilave lejohet kalimi i kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 333, datë 25.4.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË PJESE TRUALLI TË PRONËS “QENDRA E FORMIMIT POLICOR” SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “e” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të një pjese trualli të pronës “Qendra e Formimit Policor” Sauk, Tiranë, me sipërfaqe prej 2300 (dy mijë e treqind) m², pjesë e pasurisë 69/1, e ndodhur në zonën kadastrale 3266, nga Ministria e Brendshme të Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas planvendosjes (pjesa e ngjyrosur), që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sigurimin e mjediseve shtesë për veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Sipërfaqja e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN - VENDOSJA Q.F.P.



V.O/ — KUFIRI Q.F.P. SIPAS DOKUMENTIT
HIPOTEKOR

1 SIPERFAQJA E TRUALLIT ≈ 2300
QE MENDOHET TI KALOJE NE
PERGJEGJESI ADMINISTRIMI
MINISTRISE SE ARSIMIT, PER
KOMUNITETIN MUSLIMAN



VENDIM
Nr. 334, datë 25.4.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E BRENDSHME, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT DHE
SHPENZIMEVE TË TJERA TË LIDHURA ME HUMBJEN E JETËS
SË ZONJËS LINDA IHSANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 980 000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të transportit, për kthimin në atdhe nga Ankaraja (Turqi), si dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me humbjen e jetës së zonjës Linda Ihsani.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 336, datë 24.4.2013

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË DURRËSIT

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Genc Juka emërohet prefekt i qarkut të Durrësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 337, datë 26.4.2013

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 515, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE, TË MËNYRËS DHE KOHËS SË
USHTRIMIT NGA ALUIZNI TË PËRGJEGJËSIVE TË ZYRAVE TË URBANISTIKËS DHE
TË KËSHILLIT TË QARQEVE, GJATË PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT TË
OBJEKTEVE INFORMALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 1 të vendimit nr. 515, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Në rastin kur njësia e qeverisjes vendore kërkon të kryejë veprimet sipas pikave 1, 3, 3.1 dhe 3.2 të këtij vendimi, ajo i drejtohet drejtorisë përkatëse të ALUIZNI-t, me kërkesë dhe argumentim se disponon kapacitetet teknike për këto veprime. Drejtoria përkatëse e ALUIZNI-t, kur vlerëson se njësia përkatëse i ka kapacitetet teknike, ia përcjell dokumentacionin që disponon njësisë së qeverisjes vendore kërkuese, me qëllim vazhdimin e procedurës sipas kërkesave ligjore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 338, datë 26.4.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË
LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE
INFORMALE (ALUIZNI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a” e pikës 2 të vendimit nr. 289, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) 7 (shtatë) drejtori në qarkun e Tiranës.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 341, datë 24.4.2013

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Auron Mëneri, Zëvendësministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Sajmir Hoxha emërohet Zëvendësministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 342, datë 24.4.2013

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të neneve 95, pika 2 dhe 100 të Kushtetutës me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Gëzim Podgorica, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z. Basir Çollaku emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Telegrafike Shqiptare.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 343, datë 24.4.2013

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Flamur Kuçi emërohet Zëvendësministër i Punëve Publike dhe Transportit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 344, datë 24.4.2013

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 180, DATË 13.2.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E LISTËS SË MAKINERIVE E TË PAJISJEVE QË
JANË DREJTPËRDREJT TË LIDHURA ME INVESTIMIN DHE TË PROCEDURAVE TË
PËRJASHTIMEVE E TË KRITEREVE PËRKATËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “g”, “gj” e “i” të nenit 261/1 të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 180, datë 13.2.2013 të Këshillit të Ministrave, të shtohen, sipas rendit të tabelës, kodet tarifore, si më poshtë vijon:

8410 11 00 - Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që nuk i kalon 1 000 kW;

8410 12 00 - Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 1 000 kW, por nuk i kalon 10 000 kW;

8410 13 00 – Turbinat hidraulike dhe rrotat e ujit me fuqi që i kalon 10 000 kW;

8410 90 00 – Pjesët, përfshirë rregullatorët;

9022 19 00 – Skanerët me rreze X (përveç atyre të përdorur në mjekësi, kirurgji, stomatologji dhe veterinar);

9406 00 31 – Serrat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr. 346, datë 24.4.2013

**PËR KTHIMIN NË FOND BANESASH TË DISA OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË
TEKSTILEVE TË PAMBUKTA DHE OBJEKTEVE TË VJETRA TË ISH-UZINËS
“DINAMO” E RE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, 10, 11, 14 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Objektet e ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta dhe objektet e vjetra të ish-uzinës “Dinamo” e re, Tiranë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimin, në favor të banorëve të pastrehë, të cilët banojnë në këto objekte, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të bëjë kalimin në pronësi të këtyre objekteve për banorët e pastrehë, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E OBJEKTEVE TË ISH-KOMBINATIT TË TEKSTILEVE TË PAMBUKTA

Tezgjahu. Filatura nr. 1

Objekti nr. 2. Magazina e pambukut

Objekti nr. 3.

Objekti nr. 4. Karbonizimi (gjysma e objektit)

Objekti nr. 5. Hidrofil

Objekti nr. 6. Hidrofil

Objekti nr. 7. Rezervat e pambukut

Objekti nr. 8. Ish-shkolla e natës

Objekti nr. 9. Magazina e pjesëve të këmbimit

Objekti nr. 10. Ish-shkolla e ulët ngjitur me minibashkinë nr. 6

KOMBINATI

	Tezgjahu, filatura nr.1		
	Emër, atësi, mbiemër	Nr. frymë	Nr. i dhomave
1	Riza Islam Skaci	4	3
2	Manushaqe Jonuz Ura	4	2
3	Riza Rrapush Alla	3	2
4	Hmza Riza Alla	3	2
5	Tonin Pjetër Ndreca	3	2
6	Kushtrim Lama	1	1
7	Riza Rrapush Avlla	2	1
8	Fatmir Biert Tahiri	2	2
9	Altin Ndrec Gjini	7	2
10	Ndrek Zef Vogrri	6	3
11	Mark Ndue Gjoka	7	3
12	Feriz Dash Gjongecaj	5	4
13	Kastriot Preng Cungu	4	3

14	Shyrete Mehmet Cani	5	2
15	Sefedin Haxhi Gashi	4	1
16	Gafur Legjip Lloqi	4	4
17	Hamit Gafur Lloqi	2	2
18	Beqir Gafur Lloqi	5	3
19	Afrim Gafur Lloqi	2	2
20	Fran Zef Gjini	3	1
21	Edmond Fran Gjini	2	2
22	Zef Fran Gjini	2	2
23	Kastriot Gjon Palokaj	4	4
24	Mustaf Abaz Halilaj	2	2
25	Elez Isuf Papekaj	3	3
26	Gjin Lek Mema	14	2
27	Tahir Birt Tahiri	2	2
28	Zydi Gani Gjoshi	3	4
29	Jak Prend Pjetri	9	4
30	Angjelin Preng Gjoka	3	3
31	Shkëlqim Murat Vrap	4	2
32	Adrian Selman Sylaj	2	4
33	Fatime Brahim Sylaj	2	4
34	Sadik Ram Mustafvataj	4	3
35	Ali Bajram Avdi	6	3
36	Bejkush Sako Leli	4	3
37	Bashkim Gani Matoshi	6	3
38	Aishe Bubrec Matoshi	3	2
39	Shkëlzen Zeqir Sylaj	4	3
40	Sabrije Ibrahim Toska	3	3
41	Ahmet Ali Meshi	6	3
42	Shpëtim Azem Breca	4	3
43	Avdulla Syl Çela	4	3
44	Sali Shpend Nikoçi	6	3
45	Byslim Sali Nikoçi	4	2
46	Besnik Sadri Mulgeci	5	4
47	Bektash Zenel Hysko	6	3
48	Besim Isuf Cufe	4	3
49	Pal Kukel Vatnikaj	6	4
50	Hasan Halit Llapi	5	4
51	Artur Hasan Llapi	5	1
52	Alfred Ahmet Vukaj	3	2
53	Xhavit Sadri Vukaj	5	2
54	Arben Zenel Vidrica	6	2
55	Zenel Xhemal Kaloshi	4	2
56	Fadil Rexhep Berisha	6	2
57	Hazir Selman Sylaj	2	2
58	Muharrem Medi Dema	4	4
59	Jemin Selim Peka	5	4
60	Shkëlzen Jemin Peka	6	4



61	Sadri Azem Breçani	4	3
62	Tonin Stjefën Mhilli	5	4
63	Ermal Bajram Hadroi	5	2
64	Dashamir Bajram Hadroi	4	2
65	Bajram Ram Hadrpi	8	2
66	Shkëlqim Bajram Hadroi	2	1
67	Agim Bajram Hadrpi	2	2
68	Fadil Rexhep Berisha	2	2
69	Zef Dod Lala	5	2
70	Shkëndie Adem Amlia	7	3
71	Gjyste Ndoci	3	1
72	Martin Nikoll Kovaçi	5	3
73	Pavlin Nikoll Kovaçi	5	1
74	Guri Sulo Hoxha	3	2
75	Gjergji Stefan Kolvani	3	
76	Dali Hasan Kola	3	
77	Ndoc Prel Ukcama	5	2
78	Hamëz Avdyl Memia	4	2

OBJEKTI NR.2 (MAGAZINA E PAMBUKUT)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri i pjesëtarëve të familjes
1	Beqir Ali Haklaj	6
2	Halim Avdi Neza	6
3	Isa Ramadan Kovaci	10
4	Hajredin Ibrahim Cara	5
5	Fatmir Aliaj	privatizuar
6	Gani Sefedin Sallaj	2
7	Selami UkeMertinaj	5
8	Elez Hysen Haklaj	6
9	Shtjefën Miter Ukcena	3
10	Arben Çel Metaliaj	privatizuar

OBJEKTI NR. 3

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Nr. i pjesëtarëve të familjes	
1	Ded Zef Marashi	5	3
2	Alban Uke Gjonaj	4	2
3	Uke Ali Gjonaj	6	3
4	Afrim Uke Gjonaj	5	K(2) 4
5	Besnik Bajram Tahiri	4	K(3) 4
6	Çelik Avdyl Koka	5	K(3) 2
7	Arbër Uke Gjonaj	5	2
8	Zamir Gani Qelia	4	4
9	Petrit Kole Alia	4	3

10	Ndue Llesh Kola	7	3
11	Rexhe Hysen Imeraj	3	4
12	Maliq Çel Rekaj	4	3
13	Vladimir Beqir Kartoci	8	3
14	Shkelqim Mehmet Kurmetaj	13	4
15	Përparim Pjetër Ramaj	4	3
16	Zef Ndue Aliaj	9	3
17	Ilir Lazer Bushati	6	K(1+2) 4
18	Sokol Lulash Ndershtiqaj	4	K(3+4) 4
19	Pjetër Pal Bushti	11	K(1+2) 4
20	Rustem Bajram Peleposhi	5	2
21	Pjetër Gjok Pjetërgjokaj	6	K(1+2) 4
22	Ilirjan Ajet Haklaj	1	2
23	Vebie Halit Berisha	5	K(1+3) 4
24	Diana Dalip Lipo	2	K(2) 2
25	Ferit Tahir Rrahmanaj	3	2
26	Fatmir Ferit Rrahmanaj	2	K(2) 2
27	Baram Tahir Rrahmanaj	5	2
28	Bjeshkë Rustem Meshi	1	3
29	Jetmir Bajram Meshi	2	K(2) 4
30	Besim Hysen Peka	4	K(1+2) 4
31	Rexhe Sadri Imeraj	5	2
32	Avni Hysen Broshka	4	4
33	Resmi Hysen Broshka	5	4
34	Florin Mehmet Kurmekaj	7	2
35	Hysen Ibish Peka	2	2
36	Lumturie Bajram Ponari	3	2
37	Armando Fatmir Meshi	4	2
38	Erjon Rexh Imeraj	4	2
39	Artur Pjetër Ramaj	1	2
40	Hasan Ram Danaaj	5	2

OBJEKTI NR.4 (GJYSMA E OBJEKTIT)
KARBONIZIMI

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pjesëtarëve të familjes	
1	Isuf Musa Selimaj	4	3
2	Donika Josif Tresa	3	2
3	Sali Shaban Avdiaj	7	3
4	Mariglen Lytfti Hysenlikaj	3	3
5	Kol Pashko Prela	6	4
6	Valentina Todi Selimi	3	2
7	Vladimir Ram Baçi	4	2
8	Lulash Ded Stena	2	2
9	Kol Mark Shkemb	6	2



OBJEKTI NR.5 (HIDROFILI)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit	Nr. i pjesëtarëve të familjes
1	Imer Halil Haxhiaj	4
2	Isuf Halil Buçpapaj	6
3	Rustem Bajram Dusha	5
4	Halil Isuf Baçi	6
5	Xhevair Safet Bardhi	5
6	Jonuz Halit Agaj	5
7	Ramiz Hamdi Haxhia	6
8	Muharrem Rexhep Haxhia	3
9	Hajredin Muharrem Haxhia	6
10	Sadik Bajram Mulaj	3
11	Artur Sadik Mulaj	4
12	Vat Sokol Bushati	4
13	Pjetër Ndue Gjonpali	4
14	Pashk Sokol Bushati	6
15	Kol Prend Lori	5
16	Prend Marash Pepkolaj	5
17	Vat Dede Prroni	5
18	Agustin Pren Voci	6
19	Gëzim Pjetër Gjonpali	6
20	Tale Smail Dushaj	1
21	Paulin Pjetër Gjonpali	5
22	Besnik Zef Difi	4
23	Mehmet Jashar Laraku	3
24	Xhelal Hajdar Hajdari	4
25	Hatixhe Mustafa Byberi	9
26	Agim Hamez Meshi	5
27	Mereme Xhem Meshi	6
28	Zenun Halil Matoshi	6

OBJEKTI NR. 6 (HIDROFILI)

Nr.	Emri atësia mbiemri	Numri i pjesëtarëve të familjes
1	Bedri Ali Dema	2
2	Isuf Rexhep Haxhiaj	7
3	Shaban Isuf Haxhiaj	9
4	Vehbi Isuf Haxhiaj	3
5	Avion Hamid Ismalaj	4
6	Shpëtim Fadil Muca	3
7	Ismail Zeqir Ismalaj	5
8	Sali Sherif Abdia	2
9	Albert Musa Osmani	3
10	Pashke Ndue Lala	4
11	Gjete Ndue Lala	4

12	Pavlin Ndue Lala	6
13	Preng Pjetër Prenga	5
14	Ndrec Zef Prenga	5
15	Lekë Zef Prenga	5
16	Hysen Hysen Hasanaj	4
17	Isuf Sadri Hajdaraj	5
18	Agustin Mark Zeqiri	5
19	Shaban Ram Rizvani	3
20	Vjollca Musa Gjerani	4
21	Skënder Hamdi Gjyriqi	6
22	Idajet Hamdi Gjyriqi	4
23	Ukë Halil Ismalaj	5
24	Bashkim Ukë Ismailaj	4
25	Ali Man celaj	9
26	Zef Mark Prekndreaaj	6
27	Fran Zef Perknndreaaj	2
28	Qerim Mëhill Imeraj	5
29	Lule Dodë Bushgjokaj	1
30	Pjetër Kolë Ramaj	5
31	Kujtim Pjetër Ramaj	4

OBJEKTI NR.7 (REZERVAT E PAMBUKUT)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri i kryefamiljarit	Nr. i pjesëtarëve të familjes
1	Bibë Prend Beqiri	5
2	Gjon Prend Beqiri	5
3	Baisko Bashkim Kopliku	5
4	Ela Ukë Berisha	3
5	Sokol Ndoc Çokaj	3
6	Shaqe Ndue Çokaj	2
7	Dritan Tahir Tahiri	5
8	Çajup Pasho Xhebro	3
9	Luljeta Pasho Xhebro	2
10	Elisabeta Pasho Pajo	4
11	Fatmir Ardi Tara	4
12	Agron Ardi Tara	1
13	Vera Fadil Paja	4



OBJEKTI NR.8
ISH-SHKOLLA E NATËS

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pjesëtarëve të familjes
1	Pjetër Syle Gjeloši	6
2	Përparim Muharrem Caka	3
3	Frederik Vangjel Noga	5
4	Andi Muharrem Berisha	5
5	Thoma Andon Gorea	4
6	Lumturi Beqir Proko	3
7	Xhevahir Jonuz Alla	5
8	Zaim Seladin Dosku	5
9	Saimir Faslli Uka	2
10	Zenel Qemal Fusha	7
11	Musa Hekuran Hoxha	5
12	Haxhi Myrto Rama	4
13	Bardhyl Etem Lilaj	4
14	Drini Resul Malile	5
15	Hasan Etem Hasa	4

OBJEKTI NR. 9
MAGAZINA E PJESËVE TË KËMBIMIT
KATI 1

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pjesëtarëve të familjes
1	Rustem Halil Selimaj	4
2	Nikoll Ndokë Uldreaj	4
3	Idriz Sadri Nikoçi	5
4	Ali Ram Lajthiza	4
5	Stefan Andre Proko	3

KATI 2

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pjesëtarëve të familjes
1	Faik Seit Bardhi	5

Lista e banorëve që banojnë në ish Shkollën e Ulët pranë Kombinatit Tekstil Tiranë
(objekti ngjitur me minibashkinë nr.6)

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr. i pjesëtarëve të familjes	Struktura
1	Petrit Sali Bejo	3	1 + 1
2	Arjan Fejzi Murati	2	1 + 1
3	Gëzim Safet Myrtollari	5	1 + 1
4	Myslim Fadil Moqi	3	1 + 1
5	Skënder Hysen Tahirllari	4	1 + 1

6	Rahim Ibrahim Muça	4	1 + 1
7	Sherif Misar Alvora	6	1 + 1
8	Agim Ibrahim Jaho	4	1 + 1
9	Hasan Jakup Shalësi	4	1 + 1
10	Xhevahir Xheladin Kaca	6	1 + 1
11	Qemal Misar Alvora	4	1 + 1
12	Barjam Demir Hysi	6	1 + 1
13	Emilie Hysni Demiri	4	1 + 1
14	Murat Shaqir Xhelo	4	1 + 1
15	Gramoz Fejzi Murati	3	1 + 1

Lista e kryefamiljarëve që banojnë në godinat e vjetra të ish-uzinës Dinamo të Re, rr. “Jordan Misja”, njësia bashkiake nr. 9

- | | |
|--------------------|-----------------------|
| 1. Fatmir Zharku | 21. Agron Matmuja |
| 2. Ibrahim Buçaj | 22. Mark Nikolli |
| 3. Kujtim Metaliaj | 23. Pjetër Gjeçi |
| 4. Muharrem Muçaj | 24. Shkëlzen Nezaj |
| 5. Albert Zharku | 25. Hysen Hajdari |
| 6. Muharrem Buçaj | 26. Osman Martinaj |
| 7. Hazbi Papa | 27. Rexhep Martinaj |
| 8. Ismet Kerrnaja | 28. Mane Imeraj |
| 9. Sali Mertinaj | 29. Musli Kerrnaja |
| 10. Lazime Çera | 30. Adil Gjoni |
| 11. Petrit Mustafa | 31. Petrit Neza |
| 12. Fadil Imeraj | 32. Flora Kerrnaja |
| 13. Hesat Jahelezi | 33. Zeqir Imeraj |
| 14. Mahmudie Çera | 34. Agim Shiqerukaj |
| 15. Eduart Gjeçi | 35. Përparim Rrogami |
| 16. Gjovalin Gjeçi | 36. Aleksandër Gjoka |
| 17. Mark Gjeçi | 37. Rit Gjoka |
| 18. Bardhok Gjeçi | 38. Shkëlzen Dervishi |
| 19. Ded Rajta | 39. Ismail Çokaj |
| 20. Zudi Bashkurti | 40. Preng Paloka |

UDHËZIM

Nr. 383/8, datë 29.4.2013

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHËRBIMET E KOMITETIT SHQIPTAR TË BIRËSIMEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, të ndryshuar, Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave



UDHËZOJNË:

1. Për procedurat e birësimit të të miturve nëpërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve, paguhet tarifa shërbimi, si më poshtë:

- a) Nga shtetas shqiptarë, 20 000 (njëzet mijë) lekë;
- b) Birësim me pëlqim, 10 000 (dhjetë mijë) lekë;
- c) Nga shtetas të huaj, 1 000 (një mijë) dollarë për shtetasit që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Europian; ose 700 (shtatëqind) euro për shtetasit që vijnë nga vendet e Bashkimit Europian.

2. Tarifa e shërbimit të paguhet në momentin e miratimit të kërkesës për birësim.

3. Të ardhurat e siguruara nga tarifat për shërbimet e birësimeve derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit.

4. Ngarkohet Komiteti Shqiptar i Birësimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 6.5.2013
Doli nga shtypi më 6.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 28 lekë